

GJYKATA SUPREME E KOËSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nebojša Boričić, kryetar kolegji, Gyltene Sylejmani dhe Enever Peci, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen administrative sipas padisë së paditësit A. H. nga fsh....., Komuna e....., kundër vendimit të së paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), K.A.nr.231/2012 datë 20.07.2012, në çështjen e anulimit të aktit administrativ, lidhur më kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr. 342/2016 datë 22.11.2016, në seancën jopublike të mbajtur më 31.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit A. H. për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA-UZH nr. 342/2016 datë 22.11.2016

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA nr. 342/2016 datë 22.11.2016, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 276/2013 dt. 22.07.2016, me të cilën paditësi ka kërkuar anulimin e vendimit të së paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), K.A.nr.231/2012 datë 20.07.2012.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. 342/2016 datë 22.11.2016, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkak të shkeljes së të drejtës materiale me propozim që të aprovohet kërkesa e paditësit si e bazuar apo të anulohen aktgjykimet e atakuara dhe lënda të kthehet në riprocedurë.

Organi i paditur në përgjigje në kërkesë e konteston të njëjtën si të pabazuar dhe propozon që ajo të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.342/2016 dt. 22.11.2016.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoj shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA) ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e të paditurës (KPMM) K.A.nr.231/2012 datë 20.07.2012, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e paditësit dhe është shqiptuar gjoba në shumë prej 27,593.58€. Paditësi fillon konfliktin administrativ kundër aktvendimit të paditurës, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr.276/13 dt. 22.07.2016, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit KA.nr. 231/12 dt. 20.07.2012. Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.342/2016 datë 22.11.2016 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit, ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjenë se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative , me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar me të cilën është kërkuar që të anulohet vendimi i theksuar si më lartë i të paditurës.

Neni 3 të Rregullorës për Miniera dhe Minerale, përcakton mënyrën për të ushtruar veprimtari që ka të bëjë me kërkime, eksploatim, apo ndonjë veprimtari tjetër. Neni 30 i Rregullorës në fjalë parasheh procedurën për lëshimin e licencës së xehtarisë për burimet minerale në kuadër të zonës përkatëse, kurse në nenin 59 parashihet shqiptimi i sanksioneve administrative ndaj personave të cilët nuk u përmbahen dispozitave që parasheh kjo Rregullore.

Në nenin 70 të Ligjit për Miniera dhe Minerale të Kosovës nr. 03/L-163 parashin aktivitetet e jashtëligjshme të hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta e kur shfrytëzuesi nuk posedon licencë apo leje të veçant nga KPMM-ja.

Duke i pasur parasysh dispozitat e lartë theksuara të Rregullorës dhe Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163, kjo Gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vepruar kur e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit. Bazuar në të lartëtheksuarat, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje proceduralo-administrative drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, Ligjin e procedurës kontestimore, Rregullorën për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163. Komisioni i Pavarur për miniera dhe minerale ka nxjerr vendimin KA.nr. 231/12 dt. 20.07.2012, në pajtim me Rregulloren për Miniera dhe Minerale në Kosovë dhe Ligjit për Miniera dhe Minerale. Andaj kjo Gjykatë vlerëson se paditësi në rastin konkret ka shfrytëzuar resurse minerale pa u paisur me licencë valide nga organi kompetent, për këtë arsye i njëjti organ edhe i ka shqiptuar gjobë paditësit.

Gjykata Supreme gjeti se pretendimet në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, janë pa ndikim për konstatimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që ka konstatuar gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë i kontestuar është i drejtë, ligjor dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë. Kjo Gjykatë gjithashtu vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë i drejtës materiale dhe se nuk është shkel ligji në dëm të paditësit.

Nga se u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.par. 1 të Ligjit për Konfliktet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREM E KOSOVËS PRISHTINË

ARJ-UZVP NR. 34/2017 DATË 19.07.2017

Procesmbajtës,

Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,

Nebojša Boričić